



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

**Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës**  
**Tel: +381-28535725, [URL:http://www.umib.net](http://www.umib.net), Mail:rektorati@umib.net**

**RAPORT I TË HYRAVE DHE SHPENZIMEVE**  
**PËR PERIUDHËN JANAR/DHJETOR - 2019**

JANAR/2020

**P Ë R M B A T J A**

1. Hyrja.....	3
2. Analiza e Buxhetit.....	4
3. Buxheti i planifikuar dhe ndryshimet gjatë vitit fiskal 2019.....	6
4. Realizimi i buxhetit.....	9
5. Shpalosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike...10	
5.1. Paga dhe mëditje .....	10
5.2. Mallradhe shërbime.....	14
5.3 .Shpenzime komunale.....	18
5.4. Subvencione dhe transfere.....	19
5.5. Investime kapitale.....	19
6. Të hyrat vetanake.....	22

## 1. HYRJE

Bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048, neni 45 pika 45.2 lidhur me raportet buxhetore, Statutin e Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës neni 28 pika 1.9 dhe 1.10 mbi detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit, neni 180 lidhur me procedurat buxhetore, rektori në bashkëveprim me menaxhmentin e Universitetit të Mitrovicës hartoi raportin mbi realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për vitin fiskal 2019.

Raporti përmban një analizë përmbledhëse të performancës së aktiviteteve të cilat ndërlidhen me objektivat e planifikuara sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2019/2021, vendimeve nga niveli qendror(MF,MASHT), rekomandimeve të Këshillit Drejtues dhe menaxhmentit lidhur me përcaktimin e prioriteteve të bazuara në vendimin e Kuvendit të Kosovës për Buxhetin e ndryshuar për Universitetin e Mitrovicës.

Buxheti e Universitetit të Mitrovicës e karakterizon procesi i konsultimeve dhe sistemimi i të gjitha kërkesave të administratës qendrore dhe njërive akademike të harmonizuar me kufijtë final të përcaktuar nga Kuvendi i Kosovës. Kërkesat janë të harmonizuar me njësitë akademike duke konsideruar që aktivitetet të ndërlidhen me implementimin e përgjegjësisë që janë përcaktuar me fushëveprimin e institucionit të Arsimit të Lartë në Kosovë.

Raporti, përmes pasqyrave financiare,pasqyron se në ç'mënyrë institucioni i Universitetit të Mitrovicës bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2019, administroi: burimet financiare dhe shpenzimet

Pasqyrat financiare për periudhën raportuese janë të bazuara në dokumentet:

1. Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë-pasqyrimi i pasqyrave financiare.
2. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2019-2021.
3. Ligji mbi Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.
4. Buxheti për vitin 2019 për UMIB
5. Vendimet e UMIB për kursim të mjeteve buxhetore
6. Vendimi i MF për harmonizim të shpenzimeve kapitale
7. Statuti i përkohshëm për UMIB.
8. Planin e rrjedhës së parasë të bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për vitin 2019

Pasqyrat financiare janë të harmonizuara me të dhënat e sistemuara në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Financave të Kosovës(SIMFK).

## 2. ANALIZA E BUXHETIT

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike i bazuar në kufijtë final të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës për Universitetin e Mitrovicës, pasqyron mundësinë e realizimit të aktiviteteve të cilat ndërlidhen me fushëveprimin e Universiteteve Publike dhe Planit Strategjik të Arsimit të Lartë të Kosovës për vitet 2017-2021.

Kufijtë final të strukturuar nëpër kategori ekonomike janë ndërlidhur me planifikim të objektivave, aktiviteteve të planifikuara sipas Kornizës Afatmesme e Shpenzimeve për vitet 2019-2021 dhe në masë të konsiderueshme me Planin Strategjik për vitet 2018/2021 për Universitetin e Mitrovicës.

Viti fiskal 2019 mund të karakterizohet si sfidues, me faktin se aktivitetet janë përqendruar në funksionalizimin e kampusit të ri universitar. Aktivitetet janë orientuar në funksionalizim të objekteve, laboratorëve, sallave të leximit, bibliotekës dhe shërbimeve tjera që janë në funksion të krijimit të standardeve për mësim. Në të njëjtën kohë është ngritë niveli i ofrimit të shërbimeve administrative, stimulimit/bursa dhe aktiviteteve tjera që janë në shërbim të studentëve.

Hartimi dhe implementimi i programit për racionalizim të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, mundësoi që të bëhet ristrukturim ndërmjet zërave shpenzues. Mjetet janë destinuar në zëra të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e ambientit dhe funksionalizim të kampusit të ri universitar.

Buxheti final për vitin 2019 i planifikuar nga buxheti i Kosovës ishte **4.238.675.35** euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2018 është më i lartë për 1.233.454.70 euro ose me indeks prej 41.04% (3.005.220.05 euro).

Buxheti i aprovuar dhe i alokuar nga buxheti i Kosovës është realizuar në shumë prej **3.840.065.34** euro ose me indeks prej 91% që në krahasim me vitin 2018 është më i ulët për 0.62%.

Të hyrat vetanake të planifikuara nga shërbimet e ofruara për student për vitin 2019 ishin në shumë prej 114.661.00. Nga të hyrat e planifikuara janë realizuar 94.289.00 euro ose me indeks të realizimit 82.22%. Nga shuma e realizuar janë alokuar 91.706.50 euro të dedikuara për mbulimin e obligimeve në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje. Në buxhet për periudhën raportuese janë inkorporuar edhe të hyrat vetanake të bartura nga viti 2018 në shumë prej 32.478.50 euro.

Buxheti final për UMIB nga mjetet e alokuara nga Buxheti i Kosovës dhe të hyrat vetanake është 4.362.860.35 euro.

Në indeks të realizimit prej 91% ndikuan:

1. Vonesa në aprovimin e Ligjit mbi Buxhetin për Universitetin e Mitrovicës
2. Realizimi i shpenzimeve të kushtëzuara nga afatet e stërzgjatura të Ligjit të prokurimit.
3. Procedurat e tej zgjatura nga ana e OSHP për shqyrtim të ankesave nga OE.

Zyra për buxhet dhe financa ,bartëse e procesit dhe mbikëqyrjes së realizimit është përqendruar që kërkesat të jenë të harmonizuara me planifikimin e shpenzimeve të bazuar në planin e rrjedhës së parasë së gatshme dhe programin për racionalizim të shpenzimeve për vitin buxhetor 2019.


Menaxhimi financiar dhe shpenzimi i drejtë i parasë publike është pasqyruar edhe në auditimin e jashtëm për vitin 2018 i kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit të Kosovës. Objekt i auditimit ishin aktivitetet dhe shpenzimet e realizuara në kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe procedurat e realizimit të investimeve kapitale. ZKA për auditimin e kryer nuk ka dhënë vërejtje lidhur me aktivitetet që ishin bazë e auditimit.

Menaxhimi financiar, sukseset e arritura, raportet e ZKA (auditimit) dhe plotësimi i kritereve do të mundësojnë që të parashtrohet kërkesa në MASHT për pavarësim financiar, duke konsideruar se UMIB-i finalizoi strukturimin dhe ngritjen profesionale të përgjegjësve në fushën e menaxhimit të financave publike.

Nga pasqyrat e poshtë shënuara vërehet se në kontinuitet është ngritë masa buxhetore dhe paralelë me këtë edhe indeksi i realizimit që ishte si rrjedhojë e qasjes së re të menaxhimit dhe aplikimit të punës ekipore.


Buxheti i planifikuar për tre vitet e fundit të funksionimit të Universitetit të Mitrovicës i strukturuar nëpër kategori ekonomike.

Kategoritë ekonomike	Buxhet final për vitin 2017	Buxhet final I për vitin 2018	Buxheti final për vitin 2019/ buxheti i Kosovës	Indeksi I rritjes se buxhetit për vitin 2017 ne krahasim me 2016	Indeksi I rritjes se buxhetit për vitin 2018 ne krahasim me 2017	Indeksi I rritjes se buxhetit për vitin 2019 ne krahasim me 2019
1	2	3	4	5	6	7
Paga & Mëditje	2.350.264.21	2.376.887.75	2.350.457.35	4.50	1.13	(1.12)
Mallra dhe shërbime	332.899.00	371.339.00	866.339.00	45.23	11.54	133.30
Shpenzime komunale	54.340.00	160.200.00	157.200.00	8.68	294.81	(1.87)
Subvencione	10.000.00	30.000.00	100.000.00		200.00	233.33
Kapitalet	356.356.68	216.319.30	764.679.00	24.55	(60.70)	253.49
Total	3.103.859.89	3.154.746.05	4.238.635.35	14.32	1.63	34.36



Pasqyra e realizimit dhe indeksi i krahasimit për tre vitet e fundit të funksionimit të UMIB-it

Kategoritë ekonomike	Realizimi i buxhetit për vitin 2017	Realizimi i buxhetit për vitin 2018	Realizimi i buxhetit për vitin 2019	Indeksi i realizimit për vitin 2017	Indeksi për Vitin 2018	Indeksi për vitin 2019
1	2	3	4	5	6	7
Paga & Mëditje	2.350.264.21	2.347.616.75	2.349.605.35	100.00	98.77	100
Mallra&Shërbime	300160.77	281.639.44	572.030.34	90.16	75.84	66
Shpenzime komunale	53.848.97	113.188.10	154.870.08	99.10	70.65	99
Subvencione	8.575.00	29.999.75	99.780.00	85.75	100	100
Kapitalet	355.857.78	117.827.37	663.779.57	99.86	54.47	87
<b>Total</b>	<b>3.068.706.73</b>	<b>2.890.272.91</b>	<b>3.840.065.34</b>	<b>98.86</b>	<b>91.62</b>	<b>91</b>



### 3. BUXHETI I PLANIFIKUAR DHE NDRYSHIMET GJATË VITIT FISKAL 2019

#### 3.1 Buxhetit për Universitetin e Mitrovicës i bazuar në Ligjin për Buxhetin të Republikës së Kosovës nr.06-L-133

Buxheti për UMIB i aprovuar në shkurt/2019 konform Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr.06/L-133 është 4.788.969.00 euro që në krahasim me buxhetin final të vitit 2018 është më i lartë për 1.634.222.95 euro ose me indeks prej 51.80% .

Buxheti i strukturuar nëpër kategori ekonomike

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2019
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.757.430.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	866.339.00
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00
4.	SUBVENCIONE	100.000.00
5.	INVESTIME KAPITALE	850.000.00
6.	GJITHSEJ	4.788.969.00



#### Buxheti i strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti për vitin fiskal 2019	Burimet e financimit	
			Buxheti i Kosovës	Të hyrat vetanake
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.757.430.00	2.642.769.00	114.661.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	866.339.00	866.339.00	
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	215.200.00	
4.	SUBVENCIONE	100.000.00	100.000.00	
5.	INVESTIME KAPITALE	850.000.00	850.000.00	
6.	GJITHSEJ	4.788.969.00	4.674.308.00	114.661.00

#### 3.2 Buxheti final i bazuar në vendimet e MASHT dhe MF lidhur me kursim të mjeteve buxhetore për UMIB.


Me kërkesë të MF dhe MASHT janë obliguar të gjitha organizatat buxhetore dhe nën programet e tyre që bazuar në specifikat dhe vështirësitë gjatë procesit të realizimit të pasqyrojnë kursimet eventuale nëpër kategori ekonomike. UMIB gjatë vitit fiskal për shkak të respektimit të vendimeve nga MAP, MF, MASHT dhe OSHP ishte e ballafaquar me vështirësi në realizim të buxhetit të planifikuar për kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Për këtë qëllim e në respektim të vendimeve, menaxhmenti i UMIB-it sjell vendim që të kursej mjete në shumë prej 435.632.65 euro. Kursimet janë bërë nga kategoria e pagave dhe mëditjeve në shumë prej 292.311.65 euro, shpenzime komunale 58.000.00 euro dhe investime kapitale 85.321.00 euro.

Buxheti final për Universitetin e Mitrovicës për vitin fiskal (bazuar në kursime) është 4.362.860.35 euro që është më i ulët për 435.632.65 euro në krahasim me buxhetin e aprovuar në shkurt të vitit 2019.

Buxheti final i bazuar në kursime për vitin fiskal 2019:

nr	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti final i bazuar në vendimet për kursime buxhetore	Burimet e financimit		
			Buxheti i Kosovës	Të hyrat vetanake të alokuara 2019	Të hyrat vetanake të bartura nga 2018
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.474.642.35	2.350.457.35	91.706.50	32.478.50
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	866.339.00	866.339.00		
3.	SHPENZIME KOMUNALE	157.200.00	157.200.00		
4.	SUBVENCIONE	100.000.00	100.000.00		
5.	INVESTIME KAPITALE	764.679.00	764.679.00		
6.	GJITHSEJ	4.362.860.35	4.238.675.35	91.706.50	32.478.50

## Buxheti final i bazuar në vendimet për kursime buxhetore



**Paga dhe mëditje-** për vitin fiskal 2019 masa buxhetore e alokuar nga Buxheti i Kosovës për përmbushjen e obligimeve për paga është 2.350.457.35 euro që është për 26.430.40 euro më e ulët se paga finale për vitin fiskal 2018. Indeksi i zvogëlimit është për 1.12% kurse pjesëmarrja e buxhetit për paga dhe mëditje në strukturë është 53.87% të buxhetit të aprovuar.

**Mallra dhe shërbime** -Masa buxhetore për këtë kategori është 866.339.00 dhe është më e lartë për 495.060.00 ose me indeks të rritjes 133.30% në krahasim me buxhetin final të vitit 2018.

**Shpenzime Komunale-** shpenzimet komunale janë 157.200.00 euro dhe janë më të ulëta 3.000.00 euro ose me indeks prej 1.87% në krahasim me buxhetin final të vitit 2018

**Subvencionet-** mjetet e planifikuara janë në shumë prej 100.000.00 euro dhe janë më të larta për 70.000.00 euro ose me indeks prej 233.33% në krahasim me buxhetin final të vitit 2018.

**Investime kapitale-** Investimet kapitale për këtë vit fiskal janë planifikuar me shumë prej 764.679.00 euro dhe janë më të larta për 548.359.7 euro ose me indeks prej 253.49% në krahasim me vitin 2018.



#### 4. REALIZIMI I BUXHETIT

Zyra për buxhet dhe financa bartëse e procesit të ekzekutimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit, përmes pasqyrave financiare, pasqyron si është bërë menaxhimi i parasë publike duke analizuar dhe bërë krahasime me planifikim, burimet dhe realizim të mjeteve të strukturuar në kategori ekonomike.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi i buxhetit i krahasuar me burime, alokim, realizim dhe indeks të realizimit.

Kategoritë ekonomike	Buxheti FINAL për 2019	Alokimi për vitin 2019	Mjetet shpenzuara për vitin 2019	Mjete pashfrytëzuara	Indeksi i realizimit
1	2	3	4	5=3-4	6=4/3*100
Paga & Mëditje	2.474.642.35	2.350.457.35	2.349.605.35	852.00	100
Mallra&Shërbime	866.339.00	866.339.00	572.030.34	294.308.66	66.00
Shpenzime komunale	157.200.00	157.200.00	154.870.08	2.329.92	99
Subvencione	100.000.00	100.000.00	99.780.00	220.00	100
Kapitalet	764.679.00	764.679.00	663.779.57	100.899.43	87
Total	4.362.860.35	4.237.823.35	3.840.065.34	397.758.00	91


**Pagat dhe mëditjet** – janë alokuar **2.350.457.35** euro për përmbushjen e obligimeve për paga të personelit akademik të rregullt, të angazhuar dhe personelit administrativ. Për periudhën raportuese janë realizuar **2.349.605.35** euro ose me indeks të realizimit prej 100 % .

**Mallrat dhe shërbimet-** janë alokuar 866.339.00 euro dhe janë realizuar 572.030.34 euro ose me indeks prej 66 % të mjeteve të alokuara.

**Shpenzimet komunale-** janë alokuar 157.200.00 euro janë realizuar 154.870.08 ose me indeks prej 99% në krahasim me mjetet e alokuara.

**Subvencionet dhe transferet**–janë alokuar 100.000.00 euro janë realizuar 99.780.00 ose me indeks prej 100.00 % në krahasim me mjetet e alokuara.

**Investimet kapitale** -sipas planit të rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 764.679.00 dhe janë realizuar obligimet në shumë prej 663.779.57 euro ose me indeks prej 87% në krahasim me mjetet e alokuara.



## 5. Shpалosja e pasqyrave të shpenzimeve të strukturuar nëpër kategori ekonomike.

### 5.1 PAGA DHE MËDITJE

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje ishte 2.757.430.00 euro ( 2.642.760.00 BK dhe 114.661.00 THV) i planifikuar përpëmbushjen e obligimeve ndaj 196 të punësuarve ( 129 personel akademik dhe 67 personel administrativ) dhe 3 anëtar të KD të UMIB-it. Bazuar në strukturën organizative, numrin e planifikuar dhe rregulloren mbi të ardhurat personale të aprovuar nga Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës, masa e planifikuar buxhetore mbulon të gjitha pozitat e planifikuara sipas strukturës organizative për personel akademik, administrativ dhe anëtar të KD.

Universiteti i Mitrovicës ka hartuar planin e personelit për vitin 2019 për administratë dhe personel akademik i cili është i bazuar në strukturën organizative të aprovuar, numrin aktual dhe numrin e vendeve të lira. Plani nënkupton edhe disponueshmërinë e mjeteve për të mbuluar obligimet ndaj personelit aktual dhe plotësimit të vendeve të lira.

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar numri i planifikuar, aktual dhe vendet e lira duke bërë ndërlidhjen e mjeteve të planifikuara për mbulimin e të gjitha pozitave të strukturuar në planin e personelit të UMIB-it.

nr	Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje-Universiteti I Mitrovicës/numri i personelit									
kodi	MASHT	Nr. I aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen buxhetore për UMIB viti 2019	Numri aktual i të punësuarve paga e dhjetorit/2019 personeli akademik i rregullt	Numri aktual i të punësuarve paga e dhjetorit /2019 personeli akademik i angazhuar	Numri aktual i të punësuarve nëadministratë/2019	Numri aktual i të punësuarve paga e dhjetorit/2019 personeli akademik i rregullt, i angazhuar dhe p.Administrativ	Vendet e lira ne krahasim me numrin e lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2019	Pozitat e lira /personel akademik	Pozitat/vendet e lira për personelin administrativ	Tejkalim te numrit te lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin për vitin 2019
1	2	3	4	5	6	7=4+5+6	8=3-7	9	10	11
979	UMIB	196	104	44/18	45	167	29	7	22	-
979	An. KD	3								
	<b>Totali</b>	<b>199</b>	<b>104</b>	<b>18</b>	<b>45</b>	<b>167</b>	<b>29</b>	<b>7</b>	<b>22</b>	<b>-</b>

Sipas Ligjit mbi buxhetin për vitin 2019 janë të lejuar 199 të punësuar gjegjësisht 196 personel të universitetit dhe 3 anëtar të Këshillit Drejtues. Sipas udhëzimeve të Thesarit obligimet për anëtarë të K.D. janë karakterizuar si paga dhe për këtë qëllim MF ka lejuar paga/buxhet vetëm për 3 anëtarë të deleguar nga MASHT. Meqë në përbërje të KD janë të deleguar katër anëtarë nga Ministri, atëherë UMIB, ishte i obliguar që për anëtarin e katërt të bëjë ndërhyrje jo vetëm në buxhetin e lejuar për paga por edhe në numrin e lejuar për personelin akademik. Me këtë ndërhyrje është zvogëluar buxheti dhe numri i planifikuar i personelit nga 196 në 195.

Përbërja e anëtarëve të K.D. është nëntë, prej tyre në procedurë të rregullt zgjedhore nga universiteti janë përzgjedh pesë anëtarë kurse katër janë deleguar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Obligimet për paga për anëtarët e përzgjedhur nga UMIB mbulohen nga buxheti i planifikuar për paga sipas rregullores për të ardhura personale të aprovuar nga KD, kurse katër anëtarë të deleguar nga MASHT-i, sipas udhëzimit administrativ për kompensim të anëtarëve të KD të lëshuar nga ministri i MASHT-it.

Buxheti i planifikuar për mbulimin e të gjitha pozitave të pasqyruar në planin e personelit dhe anëtar të Këshillit Drejtues të UMIB-it për vitin 2019

nr	Gjendja në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje-Universiteti I Mitrovicës/buxheti/ personel akademik dhe administrativ/implikimet									
kodi	MASHT	Nr. i aprovuar sipas Ligjit mbi Ndarjen buxhetore për UMIB viti 2019	Numri i personelit të UMIB –it bazuar ne pagën e dhjetorit	Buxheti i planifikuar për vitin fiskal 2019	Buxheti i planifikuar për 4 anëtar të deleguar të KD	Buxheti i planifikuar për personelin akademik aktual dhe i angazhuar gjithsej 122(104+18) paga e dhjetorit	Buxheti sipas kërkesës për plotësim të vendeve/avancim dhe përmes konkursit gjithsej 7 personel akademik	Buxheti i planifikuar për personelin administrativ aktual gjithsej 45	Buxheti sipas kërkesës për plotësim të vendeve/pozitave të lira në administratë/plani i personelit gjithsej 22 pozita	Implikimi buxhetor
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10=5-(6+7+8+9)	
979	UMIB	195	169	2.745.406.00		2.092.676.20	115.002.34	402.498.72	135.228.74	-
979	An. të deleguar të KD	4	4	12.024.00	12.024.00					
	<b>Totali</b>	<b>199</b>	<b>173</b>	<b>2.757.430.00</b>	<b>12.024.00</b>	<b>2.092.676.20</b>	<b>115.002.34</b>	<b>402.498.72</b>	<b>135.228.74</b>	<b>-</b>

Struktura e burimeve të mjeteve të planifikuara për paga .

Nr	Emërtimi i burimeve të financimit	Shuma e planifikuar sipas Ligjit mbi buxhetin 2019/janar	Buxheti final me ndryshimet/kursime	Alokimi	Realizimi
1.	Nga Buxheti i Kosovës	2.642.769.00	2.642.769.00	2.350.457.35	2.349.605.35
2.	Kursimet e mjeteve nga pagat		(293.163.65)		
3.	Të hyrat vetanake të realizuara për 2019	114.661.00	91.706.50		
4.	Të hyrat vetanake të bartura të vitit 2018	32.478.50	32.478.50		
5.	Gjithsej burimet 1-4	2.789.908.00	2.496.144.35	2.350.457.35	2.349.605.35

Në tabelën e poshtë shënuar është pasqyruar realizimi i pagave dhe indeksi i realizimit në raport me alokimin nga Buxheti i Kosovës për vitin fiskal 2019.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Paga e planifikuar bazuar në Kursimet e lejuara buxhetore për vitin 2019/BK	Alokimi e mjeteve për paga për vitin 2019	Pagat e realizuara për vitin 2019	Indeksi i realizimit në raport me mjetet e alokuara për /2019
	1	2	3	4	5=4/3*100
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.350.457.35	2.349.605.35	2.349.605.35	100

Universiteti i Mitrovicës, bazuar në planin e personelit akademik dhe administrativ planifikoi që të bëjë plotësimin e vendeve të lira konform buxhetit të planifikuar. Bazuar në disponueshmërinë e mjeteve janë zhvilluar procedurat, mirëpo procesi është pezulluar nga MAP. UMIB-i ishte i obliguar që të respektoj vendimin për pezullim dhe me këtë edhe rekrutimin e personelit administrativ të planifikuar sipas planit të personelit për vitin 2019.

UMIB duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale dhe pezullimin ishte e obliguar që për mjetet e planifikuara për plotësim të vendeve të lira të punës të pasqyroj si kursim të mjeteve për vitin fiskal 2019.


Pasqyrë e kursimit të mjeteve për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje për vitin fiskal 2019 nga të hyrat e planifikuara nga Buxheti i Kosovës në shumë prej 293.163.65 euro.

Nr	Planifikimi i buxhetit sipas Ligjit mbi Ndarje Buxhetore për vitin 2019/BK	Kursime për vitin 2019	Buxheti bazuar në kursimet për vitin 2019
	1	2	3=1-2
1	2.642.769.00	293.163.05	2.350.457.35

#### Pasqyrë krahasuese e realizimit të pagave për vite 2017/2019


Periodha e viteve 2017/2018 karakterizohen si sfiduese me faktin se UMIB është ballafaquar me mungesë të mjeteve buxhetore për realizimin e obligimeve për personel. Mbulimi i minuseve në paga është mbuluar në fund të çdo viti fiskal nga ana e Qeverisë. Në vitin fiskal 2019 Kuvendi i Kosovës duke analizuar gjendjen aktuale të pagave, për vitin 2019 akordoi buxhet shtesë duke mundësuar që të realizohet plani i personelit sipas numrit të lejuar me Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për UMIB.

Kategoritë ekonomike	Realizimi i buxhetit për vitin 2017	Realizimi i buxhetit për vitin 2018	Realizimi i buxhetit për vitin 2019
Paga & Mëditje	2.350.264.21	2.347.618.25	2.349.605.35




## Pasqyra e realizimit të pagave të planifikuara, të strukturuar sipas realizimit mujor për UMIB

NR	UMIB	Perso n. Admi nist	Shuma	Perso nel akade m.	shuma	Perso nel. anga zh.	shuma	Totali	Shuma
1	JANAR	49	30.350.98	97	145.238.21	52	6.838.61	198	182.427.80
2	SHKURT	49	30.254.86	101	146.462.90	49	14.115.15	198	190.832.90
3	MARS	49	32.630.68	102	166.164.93	49	371.00	199	199.166.61
4	PRILL	48	30.923.04	102	166.886.38	49	20.163.27	199	217.972.47
5	MAJ	48	32.887.48	104	171.634.00	47	18.610.60	199	223.132.08
6	QERSHOR	48	32.466.24	104	166.129.99	48	16.393.10	200	214.989.30
7	KORRIK	48	31.331.04	104	158.653.09	48	2.518.32	200	192.502.45
8	GUSHT	48	30.515.45	104	159.060.88	48	2.277.95	200	191.854.28
9	SHTATOR	47	29.265.78	104	144.409.87	48	315.00	199	173.990.6
10	TETOR	47	29.512.32	104	136.058.50	46	2.749.80	198	168.320.65
11	NËNTOR	45	29.268.42	104	144.617.40	47	1.826.16	197	174.512.00
12	DHJETOR	45	44.918.03	105	169.469.80	46	4.316.97	196	218.704.10
13	Gjithsej		384.323.90		1.874.786.00		90.495.28		2.349.605.00



Nga pasqyra e lartë shënuar vërehen se shuma prej 1.874.786.00 euro është shpërndarë për personelin akademik ose 79.79% të shumës së shpërndarë(2.349.605.00),për personelin akademik të angazhuar janë shpërndarë 90.495.28 euro ose 3.85% dhe për personelin administrative të strukturuar në administratën qendrore(rektorat) dhe njësitë akademike shuma prej 384.323.90 euro ose 16.35% të shumës së shpërndarë për periudhën raportuese.



## 5.2 MALLRA DHE SHËRBIME

Për vitin buxhetor janë planifikuar 866.339.00 euro për të përmbushur aktivitetet e planifikuara sipas programit për racionalizim të shpenzimeve. Planifikimi i funksionalizimit të kampusit të ri universitar, krijimi i kushteve sipas standardeve shtyri menaxhmentit që të bëjë harmonizimin e nënkodeve mes kategorive ekonomike. Qëllimi ishte që me kursim të mjeteve të krijohet masa buxhetore e cila do të jetë më se e nevojshme për ngritjen e nivelit për shërbime dhe mësim sa më kualitativ.

Mjetet janë destinuar për kompletimin e hapësirave për mësim me inventar dhe mjete tjera që janë në shërbim të mësim mbajtjes, bibliotekës me kompjuterë dhe pajisje tjera, hapësirave për informim dhe qëndrim ditor, pajisja me teknologji informative dhe komunikim, pajisje tjera që janë në shërbim të laboratorëve dhe shpenzime tjera që do të përmirësojnë nivelin e shërbimeve për student, personel akademik dhe administrativ.

Buxheti për mallra dhe shërbime për periudhën raportues ishte 866.339.00 euro, janë alokuar mjete në po të njëjtën shumë. Indeksi i realizimit prej 66 % mund të konsiderohet i suksesshëm me faktin se gjatë vitit jemi ballafaquar me vështirësi në implementimin e projekteve të planifikuara. Për shkak të procedurave të stërzgjatura të prokurimit dhe vonesave të sjelljes së vendimeve nga OSHP ishte i pamundur realizimi/furnizimi për inventar për bibliotekë dhe hapësirave për mësim në shumë prej 159.000.00 euro si dhe rregullimi i hapësirave të bibliotekës, qëndrim ditor dhe këndeve informuese në shumë prej 124.000.00 euro. Shuma 283.000.00 e dedikuar për këtë qëllim zvogëloi indeksin e realizimit për 32.66 % për këtë kategori ose për 6.67 % në total të buxhetit të alokuar për UMIB.

Zyra për buxhet dhe financa bazuar në përgjegjësitë ka zotuar mjetet për këtë kategori me indeks prej 100% ose mjetet e angazhuara bazuar në planifikimin e aktiviteteve janë me indeks prej 100% kurse realizimi për shkaqe të lartë përmendura është me indeks prej 66%.

Për periudhën raportuese bazuar në planin e rrjedhës së parasë janë alokuar mjete në shumë prej 866.339.00 euro, janë realizuar 572.030.34euro.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi i mjeteve sipas buxhetit	Alokimi i mjeteve	Mjetet shpenzuara-	Indeksi i realizimit
	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5=4/3*100</b>
1.	MALLRA DHE SHËRBIME	866.339.00	866.339.00	572.030.34	66%

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar shpenzimet të strukturuar nëpër kode ekonomike duke bërë krahasime me mjetet e planifikuara sipas ndarjes buxhetore, alokimin e mjeteve dhe realizimin për periudhën raportuese.

KODI EKONOMIK	KATEGORIA EKONOMIKE	BUXHETI PËR VITIN 2019	MJETET E SHPENZUARA PËR VITIN 2019	MJETET E SHPENZUARA NË %
		<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3 = 2:1*100</b>
013000	Mallrat dhe shërbimet	866,339.00	572,030.34	66
013100	Shpenzimet e udhëtimit	-	13,346.09	
013130	Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit			
013140	Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit		6,147.89	
013141	Shpenzimet te vogla		2,704.00	
013142	Akomodimi - udhëtimet zyrtare jasht vendit		2,377.00	
013143	Shpenzime tjera - udhëtimeve zyrtare jashtë vendit		2,117.20	
013300	Shërbimet e telekomunikimit	28,343.42	23,089.05	81
013310	Shpenzimet per Internet	5,024.56		
013320	Shpenzime tjera telefonike - Vala 900	21,800.42	23,063.35	106
013330	Shenzimet postare	518.44	25.70	5
013340	Shpenzimet për përdorim të kabllit optik	1,000.00		
013400	Shpenzimet për shërbimet	55,459.09	109,225.79	197
013410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	4,459.09	1,160.00	26
013440	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës			
013440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse			
013450	Sherbime shtypje-jo marketing	20,000.00	2,387.00	12
013460	Sherbime tjera kontraktuese	30,000.00	103,798.79	346
013470	Sherbimet teknike	1,000.00		
013480	Shpenzimet për anëtarësim		1,880.00	

013495	Pagesa për Vendime Gjyqësore			
013500	Blerja e mobilieve dhe pajisjeve më pak se 1000 Euro	539,664.76	183,201.58	34
013501	Mobilje	332,000.00		
013502	Telefona	23,000.00	21,183.80	92
013503	Kompjuterë	105,840.15	98,620.00	93
013504	Harduer për teknologji informative			
013509	Pajisje tjera	78,824.61	63,397.78	80
013600	Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	16,827.26	47,996.37	285
013610	Furnizime për zyrë	11,327.26	42,898.48	379
013620	Furnizim me ushqim dhe pije(- jo dreka zyrtare)	2,000.00	3,442.89	172
013640	Furnizime pastrimi	500.00		
013655	Furnizim me preparate kimike	2,000.00		
013660	Akomodimi	1,000.00	1,655.00	166
013700	Derivatet dhe lëndët djegëse	5,688.44	1,857.68	33
013710	Vaj	1,500.00		
013780	Karburant për vetura	4,188.44	1,857.68	44
013800	Llogarite e avansit	9,324.61		-
013810	Avansper para te imeta(p.cash)	2,000.00		
013820	Avansperudhetime zyrtare	7,324.61		
01395	Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	63,600.00	49,602.70	78
013950	Regjistrimi i automjeteve		1,025.30	
013951	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	3,000.00	140.00	5
013952	Taksat komunale e regjistrimit të automjeteve	600.00	345.00	58
013953	Sigurimi i ndërtesave dhe tjera	60,000.00	48,092.40	80
014000	Mirëmbajtja	129,431.42	129,564.28	100
014010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2,500.00	974.00	39
014020	Mirëmbajtja e ndërtesave	80,363.63	99,077.12	123
014040	Mirëmbajtja e teknologjisë informative	43,067.79	28,457.00	66
014050	Mirëmbajtja e mobilieve dhe pajisjeve	3,500.00	1,056.16	30
014200	Shpenzimet e marketingut	10,000.00	3,314.00	33
014210	Reklamat dhe konkurset	2,000.00	1,600.00	80
014220	Botimet e publikimeve	4,000.00		-



014230	Shpenzimet per informim publik	4,000.00	1,714.00	43
014300	Shpenzimet e përfaqësimit	8,000.00	10,781.80	135
014310	Drekat zyrtare	8,000.00	10,781.80	135
014400	Shpenzime për vendime të gjykatave	-	51.00	-
014410	Shpenzime për vendime të gjykatave		51.00	-

Aktivitetet e realizuara ishin konform planifikimit të planit të rrjedhës së parasë të hartuar në bashkëveprim me përgjegjësit e njësive akademike dhe zyrave të administratës qendrore. Me propozim të menaxhmentit për ngritjen e nivelit të shërbimeve për student dhe përmbushjes së obligimeve për ekspertët në procesin e akreditimit, KD sjell vendim për racionalizim të shpenzimeve në kode dhe nën kode ekonomike. Zyra për buxhet dhe financa bazuar në vendimin ka aplikuar racionalizimin dhe harmonizimin mes zërave buxhetore.

### 5.3. SHPENZIMET KOMUNALE

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2019 ishte i bazuar në shpenzimet e kalkuluar për funksionalizim të objekteve në kampus të ri universitar. Buxheti i planifikuar për këtë kategori për mbulimin e të gjitha shpenzimeve komunale ishte 215.200.00 euro. Gjatë periudhës raportuese është aplikuar kërkesa dhe apeli tek njësitë akademike(objektet universitare,periudha janar/prill) për racionalizim të shpenzimeve që vërehet edhe në zvogëlim të shpenzimeve për të gjitha kodet ekonomike të kategorisë së shpenzimeve. Prolongimi i inaugurimit të objektit të dytë universitar mundësoi që të kursehen mjetet buxhetore në shumë prej 58.000.00 euro.Kursimi është aplikuar edhe me kërkesë të MASHT për këtë kategori ekonomike. Kursimet për shkak të kohës së shkurt të veprimit nuk kanë mundur të ridestonohen në kategorinë mallra dhe shërbime.

Buxheti final, bazuar në kursimet ishte 157.200.00 euro, janë alokuar mjete në shumë prej 157.200.00 euro duke shpenzuar 154.870.08 euro ose 99% të shumës së alokuar.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas kursimeve	Alokimi i mjeteve	Shpenzimet e realizuara	Indeksi i realizimit
		1	2	3	4=3/2*100
1	SHPENZIME KOMUNALE	157.200.00	157.200.00	154.870.08	99

Në tabelën e poshtë shënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas kodeve ekonomike.

<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2019</b>	<b>Shpenzimet realizuara</b>	<b>Indeksi I realizimi</b>
<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5=4/3*100</b>
1.	Energjia elektrike	50.000.00	48.177.26	96
2.	Shpenzimet e ujit	5.500.00	5.459.58	99
3.	Mbeturina	5.700.00	5.568.00	98
4.	PTK	3.000.00	2.981.23	99
5.	Ngrohja qendrore	93.000.00	92.684.01	100
6	<b>Totali</b>	<b>157.200.00</b>	<b>154.870.08</b>	<b>99</b>

#### 5.4 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Planifikimi i mjeteve buxhetore për kategorinë e subvencioneve në shumë prej 100.000.00 euro është bërë për t'i stimuluar studentët për lirim nga pagesa, stimulimin e studentëve për të arriturat dhe aktivitetet tjera si dhe shpërblimi i studentëve të dalluar me bursa.

Bazuar në buxhetin e alokuar ,Këshilli Drejtues sjellë vendim që të shpallet konkursi për stimulimin e studentëve të dalluar për vitet akademike 2018/2019 dhe 2019/2020,si dhe shpërblimin e studentëve për të arriturat në mësimnxënje duke u ndërlidh edhe me aplikimin në praktik,garat e dijes në nivel të universitetit si dhe aktivitetet tjera studentore.

Për këto qëllim janë alokuar mjete në shumë prej 100.000.00 euro dhe janë realizuar 99.780.00 euro.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Alokimi i mjeteve	Realizimi për 2019	Indeksi i realizimi
	1	2	3	4	5=3:2*100
1	SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	100.000.00	100.000.00	99.780.00	100

Në tabelën e poshtë shënuar, në mënyrë analitike, janë pasqyruar shpenzimet sipas nën kodeve ekonomike.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Bursa e studentëve për vitin akademik 2018/2019	Bursa e studentëve për vitin akademik 2019/2020 /pjesa e parë	Shpërblimi i studenteve për të arritura/aplikim praktik	Garat e dijes për student	Gjithsej
	1	2	3	4	5	6=2+3+4+5
1	Numri i studenteve	55	72	10	4	141
2	Shuma e realizuar	55.000.00	42.480.00	1.500.00	800.00	99.780.00

Për dy vitet e fundit akademik shuma e bursës për student është 1.000.00 euro. Për vitin akademik 2019/2020 është shpërndarë vetëm pjesa e parë(mungesë e buxhetit) në shumë prej 42.480.00 kurse pjesa e dytë në shumë prej 57.520.00 euro do të realizohet në vitin buxhetor 2020 (në mars me alokim të buxhetit).

#### 5.5 INVESTIMET KAPITALE

Bazuar në Ligjin mbi Ndarjen Buxhetore për këtë vit fiskal, për investime kapitale janë planifikuar mjete në shumë prej 850.000.00 euro që në krahasim me vitin 2018 masa buxhetore është rritur për 548.500.00 ose me indeks prej 181.92% . Mjete e planifikuara në shumë prej 850.000.00 euro është ndarë për pajisjen e laboratorëve të njësive akademike,pajisje me teknologji informative e cila do të jetë në funksion të funksionimit të laboratorëve dhe ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës së objekteve të ndërtuara.

Nr.	Njësia akademike	Emërtimi i investimeve	Shuma
1.	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike	<i>Furnizimi me pajisje të inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike</i>	100.000.00
2.	Fakulteti i Gjeoshkencave	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të gjeoshkencave</i>	260.000.00
3.	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore	<i>Furnizimi me pajisje për laborator të teknologjisë ushqimore</i>	430.000.00
4.	Rektorat/njësi akademike	<i>Furnizimi me pajisje për teknologji informative</i>	30.000.00
5.	Rektorat/njësi akademike	<i>Ndërtimi i infrastrukturës së universitetit/Kampusi</i>	30.000.00
6.	Gjithsej /2019		850.000.00

Për periudhën raportuese buxheti i dedikuar për këtë kategori është alokuar në shumë prej 850.00.00 euro. Mjetet e planifikuara janë zotuar sipas projekteve të aprovuara në shumë prej 850.000.00 euro. Për shkak procedurave të tej zgjatura të prokurimit, problemeve të natyrës së furnizimit të operatorëve me pajisje të kontraktuara si dhe vonesat në sjelljen e vendimeve të Organit për Shqyrtim Publik - OSHP, investimet e planifikuara janë realizuar në shumë prej 663.779.57 ose me indeks prej 87%.

Bazuar në kërkesën e MF dhe MASHT, organizata buxhetore me nën programe e tyre janë obliguar që bazuar në specifikat dhe analizën e realizimit të buxhetit të dedikuar, të paraqesin kursimet eventuale për investime kapitale. UMIB në bashkëveprim me zyrën e prokurimit dhe udhëheqësit e njësive akademike për shkak të specifikave të lartë cekura ka proceduar kërkesën për kursim të mjeteve në shumë prej 85.321.00 euro. Qeveria ka shqyrtuar kërkesën për kursime duke aprovuar shumën prej 85.231.00 euro. Prandaj buxheti final pas aprovimit të vendimit të Qeverisë ishte 764.679.00 euro.

Pasqyrë e planifikimit, alokimit dhe realizimit të mjeteve për 2019


Nr .	KATEGORIA EKONOMIKE	Planifikimi sipas buxhetit të aprovuar	Mjetet kursyera nga projektet e planifikuara	Buxheti i bazuar në kursimet e pasqyruara	Realizimi për j /2019	Indeksi realizimit i
1.	1	2	3	4	5	6=5:4*100
	Investime kapitale	850.000.00	85.231.00	764.679.00	663.779.57	87

Pasqyrë e gjendjes së realizimit të investimeve kapitale të strukturuar sipas projekteve për furnizim të pajisjeve për laboratorë të njësive akademike, administratë qendrore.

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti i planifikuar për realizim të projekteve sipas L. për buxhetin 2019	Shuma e kontratasë së nënshkruar	Realizimi	Kursimi	Mjetet mbetura	Komente
1	2	3	4	5	6	7=3-(5-6)	7
14040	Ndërtimi dhe renovimi i infrastrukturës në UMIB/porta hyrëse në kampus	30.000.00	29.982.28	23.023.98		6.976.02	Bartja e fazës së dytë të ndërtimit
15258	Furnizimi me pajisje për FIMK/makinë tornuese horizontale CNC	100.000.00	97.489.00	97.489.00	2.511.00		
15259	Furnizim me pajisje për FTU	430.00.00					
	1. Furnizimi me pajisje për kompletim të laboratorit		257.550.00	257.550.00			
	2. Furnizim me pajisje për laborator		88.358.40			89.640.00	Bartje për shkak të afatit të furnizimit
	3. Furnizim me pajisje për laborator				82.810.00		Kursim për shkak të vonës së vendimit të OSHP
15260	Furnizim me pajisje për FGJ	260.000.00				4.238.41	
	1. Pajisje për matjen e proçkave të ujit të vogël (elektromagnetike)		14.878.00	14.878.00			Mbetja në shumë prej 4.238.41 për shkak të ndryshimit të shumës së alokuar dhe të realizuar të ofertave..
	2. Mikroskop,sistemi i matjes me ultra zë CASAGRANDE.		74.528.21	74.528.21			
	3. Pajisja për laborator të Metalurgjisë.		79.175.00	79.175.00			
	4.Pajisje për laborator për gjeoshkencë		71.814.13	71.814.13			
	6. Pajisje për laborator për gjeoshkencë		15.366.25	15.366.25			
15261	Furnizim me pajisje të T.I.	30.000.00	29.965.00	29.965.00		35.00	
	gjithsej	850.000.00	759.405.59	663.789.57	85.321.00	100.889.43	764.679=663.789+100.889.43

Indeksi i realizimit prej 87% konsiderohet si shumë i suksesshëm përkundër faktit se gjatë vitit jemi përballë: me procedurat e tej zgjatura të prokurimit, ankesave të operatorëve dhe vonesa në zgjedhjen e ankesave të OE të OSHP.

Realizimi i buxhetit për vitin 2019 për investime kapitale në krahasim me vitin 2018 është më i lartë për 545.952.20 euro ose me indeks prej 563.34%.



## 6. TË HYRAT VETANAKE


Bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencat e dala nga Ligji mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës dhe udhëzimit administrativ të MASHT-it nr. 17/2014 për përcaktim të lartësisë së tarifave për ofrim të shërbimeve për studentë, për periudhën raportuese janë inkasuar 94.289.00 euro (niveli Bachelor dhe Master) dhe janë të dedikuar vetëm për mbulimin e obligimeve për kategorinë paga dhe mëditje. Indeksi i realizimit të grumbullimit të hyrave nga shërbimet e ofruara është 82.22% në krahasim me mjetet e planifikuara prej 114.661.00 euro.

Në tabelën e poshtëshënuar janë pasqyruar të hyrat vetanake të planifikuara, inkasimi, alokimi, dhe shpenzimet.

	Planifikimi sipas Ligjit mbi Buxhetin për 2019	Të hyrat e bartura nga viti fiskal 2018	Inkasimi i THV për 2019	Indeksi i realizimit
	1	2	3	5=3:1*100
<b>1</b>	<b>114.661.00</b>	<b>32.478.50</b>	<b>94.289.00</b>	<b>82.22</b>

### Të Hyrat e realizuara të strukturuar sipas njësive akademike

Nr	Përshkrimi i të hyrave-pagesave	F A K U L T E T I / N J Ě S I A A K A D E M I K E						TOTALI
		FIMK	FTU	FGJ	EDUKIM	JURIDIK	EKONOMIK	
1	Për certifikatë të notave dhe diplomës	790.00	445.00	335.00	660.00	287.50	332.50	2.850.00
2	Për diplomë dhe mbrojtje të diplomës	345.00	185.00	245.00	355.00	85.00	195.00	1.410.00
	Për mbrojtje të diplomës/master	1.100.00	1.400.00	1.300.00				3.800.00
3	Për paraqitje të provimeve/master	475.00	2.222.50	1.177.50				3.875.00
4	Për provim pranues për regjistrim për studime master							0
5	Për provim pranues/plotësues							0
6	kërkese për transfer te notave dhe ndërrimtë kartelës	247.5	74.00	55.00	69.00	45.00	28.00	518.50
7	Për semestër për studentë të rregullt	17.150.00	9.535.50	4.075.00	17.050.00	10.200.00	4.525.00	62.535.50
8	Për semestër për studime master	300.00	13.250.00	5.750.00				19.300.00
9	<b>Gjithsej</b>	<b>20.407.50</b>	<b>27.112.00</b>	<b>12.937.50</b>	<b>18.134.00</b>	<b>10.617.50</b>	<b>5.080.50</b>	<b>94.289.00</b>



Pasqyra e planifikimit, bartjes së mjeteve dhe alokimit të të hyrave vetanake.

Nr .	TË HYRAT VETANAKE	Bartja e të hyrave nga viti 2018	Planifikimi i të hyrave vetanake	Realizimi i të hyrave vetanake	alokimi	Të hyrat e shpenzuara	Mbetja e të hyrave/bartja në vitin 2019
	1	2	3	4	5	6	7=(2+4)-5
1		32.478.50	114.661.00	94.289.00	91.706.50		126.767.50

Zyra për buxhet dhe financa bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues për lirimin e studentëve për shërbimet për regjistrim të vitit akademik ka bërë kthimin e mjeteve për studentët të cilët kanë plotësuar kriteret e përcaktuara. Shuma e mjeteve të kthyera është 5.350.00.00 euro.

Pasqyrë e mjeteve të kthyera për studentë të strukturuar sipas kategorive të përcaktuara në vendim.

Nr.	KATEGORIJA	Niveli bachellor		Niveli master		Totali 5=2+3	Komente 6
		1 Nr.stud entëve	2 shuma	3 Nr.stud entëve	4 shuma		
1.	Dy apo më shumë student në familje	34	1.550.00	13	3.300.00	4.850.00	Çmimi për studime bachellor 25 master 150.00
2.	Student –fëmijë të dëshmorëve /veteran	4	200.00	1	300.00	500.00	
3.	<b>Totali</b>		<b>1.750.00</b>		<b>3.600.00</b>	<b>5.350.00</b>	Në nivel bachellor një student ka paguar 2 herë